

TOMORROW'S STUDENT *2024*

5 vjet "TES"



MUAJI I LETËRSISË MES LETRARËSH

ZIJA ÇELA, VIOLA ISUFAJ,
DURIM CACA

KONFERENCA E FILOZOFISË

RAPORTI I TË RINJVE ME MEDIAN
SI BURIM I SË (PA) VËRTETËS
SONILA MEÇO, BLENDI SALAJ
BRUNILDA ZENELAGA, ERVIN GOCI

"KALEIDOS" RRËMBEN ÇMIMIN "SIPËRMARRJA SOCIALE"

"KOSOVA", PJESA E BRISHTË E
SHPIRTIT TONË SHQIPTAR

CAMBRIDGE

SCIENCE
STEAM

TRIUMFUES NË KONKURSE



shkolla_tes



Shkolla Tomorrow's Education System



<https://tes.al/>



+355 69 370 0037

PASQYRA E LËNDËS

5-VJETORI I SHKOLLËS “TES”	03
MUAJI I LETËRSISË MES LETRARËSH	05
TETORI ROZË.....	07
DITA BOTËRORE E SHËNDETIT MENDOR.....	08
VENDLINDJA “KOSOVA”	09
RAPORTI I TË RINJVE ME MEDIAN SI BURIM I SË (PA) VËRTETËS	11
KALEIDOS RRËMBEN ÇMIMIN “SIPËRMARRJA SOCIALE”.....	13
REDEBATE, JUNIOR ACHIEVEMENT.....	15
DITA E MËSUESIT.....	16
CAMBRIDGE NË “TES”	17
JAVA E SHKENCËS.....	18
KONKURSI HIPPO.....	19
JAVA E GJUHËVE TË HUAJA.....	20
QEVERIA E NXËNËSVE.....	21
DITA E TOKËS.....	22
FESTA E ABETARES.....	23
NJË FITORE DRITHËRUESE.....	25
BIBLIOTEKA E SHKOLLËS.....	26
KLUBET NË “TES”	27
EKSPOZITA “BREZI I HUMBUR”	31
EKSPOZITA E KLUBIT TË PIKTURËS.....	32
TRIUMFUES NË KONKURSE.....	33

5 vjet "TES"

"Rrugëtimi ynë, 5 vjet në udhën e edukimit".



Prezantuesit, Etjen Kallabaku dhe Rejsi Ahmetaj

Për shkollën "TES" viti 2023-2024 shënon 5-vjetorin e themelimit. Për të festuar këtë moment të rëndësishëm, u organizuan një sërë aktivitete me natyrë kulturore, artistike, sportive, argëtuese e konkurse, të cilat nxitën talentin krijues dhe motivuan artistët e vegjël të shkollës sonë.

"Talent në TES" ishte konkursi i këngës, i cili evidentoi zërat më të bukur e që kulmoi me një finale emocionuese, në të cilën juria me përfaqësi artistët Sidrit Bejleri, Armando Likaj, Bledar Domi dhe mësuesin e muzikës Endri Llaha, përzgjedhi si zërat më të bukur të shkollës nxënëset Anais



Endri Llaha, Bledar Domi, Sidrit Bejleri, Dizhan Aga, Anais Osmënaj, Melodi Agolli, Armando Likaj

Osmënaj për ciklin AML, Melodi Agolli për ciklin AMU dhe Dizhan Aga për ciklin AF.

Në vazhden e konkurseve artistike nxënësit shprehën talentin e tyre në shkrimin eseistik dhe poetik ku triumfuan Rejhana Husha për esenë më të mirë me titull "Shkolla ime", Rejana Biçaku për ciklin AF dhe Amar Bregu me poezinë "Për shkollën time" ciklin AMU. Kur flasim për shprehje artistike ngjyrat janë ato që gjallërojnë jetën kështu nxënësit u paraqitën në konkursin e pikturës me krijime të larmishme duke treguar sesi pikturohet shkolla në mendjet e tyre.



Rejhana Husha me kupën e 5-vjetorit

Krijimet ishin mjaft të arrira, por kupën e 5-vjetorit e rrëmbeu nxënësja Kejsi Jangozi. Edhe në shkenca u zhvilluan konkurse si ai i shahut, në të cilin u shpall fitues nxënësi Redion Cara.



Maratona e konkurseve zgjati plot tre muaj dhe i përfshiu nxënësit në gara të fushave të ndryshme. Aktiviteti festiv bëri bashkë të gjithë stafin mësimor, drejtues dhe themelues, miq të shkollës ndër vite, të cilët përshëndetën arritjet e institucionit dhe gëzuan të gjithë së bashku për punën, për sukseset, për sfidat e tejkaluara dhe mbi të gjitha për vijimësinë e kësaj ndërmarrjeje madhore.

Dy aktivitete mjaft të veçanta ishin ato të ekipit të anglishtes, “TED TALK” dhe “Spelling Bee”, në të cilat nxënësit demonstruan aftësitë e tyre në njohjen e gjuhës së huaj. Kupën e konkursit “Spelling Bee” e rrëmbeu nxënësi Damian Kalleshi.



Damian Kalleshi



Risi që himni i shkollës, “E ardhmja ndrin” me tekst nga Irida Xhura dhe Miranda Sami Shehu, muzikë dhe orkestrim nga kompozitori i mirënjohur Edmond Zhulali, këndoi Anais Osmënaj, Sara Kaçi, Mine Mena, Melodi Agolli, Akid Mehmeti dhe Amad Bejlери.



Anais Osmënaj

“TES

*Ngado të shkoj anembanë
Unë emrin tënd në zemër do ta mbaj
Vendi ku mendjen e ndriçoj
Me ty të ardhmen ndërtoj”*



MUAJI I LETËRSISË MES LETRARËSH

Të ftuar nderi shkrimtarët e studiuesit Zija Çela, Viola Isufaj, Durim Çaça

Misionari i letërsisë shqipe, shkrimtari i disa romaneve, figura e dashur për lexuesit, zoti Zija Çela ishte i ftuar mes gjimnazistëve, me rastin e muajit të letërsisë. Ai zhvilloi një bashkëbisedim të ngrohtë me nxënësit për letërsinë, forcën e saj dhe dashurinë për librat.

Autori ndau përvojat e tij jetësore duke na dhënë mesazhe të shumta, duke analizuar problematikat e realitetit shqiptar, duke theksuar vlerën dhe figurën e gruas, familjes e atdheut. Me një modesti e dashamirësi të rrallë ai përcolli mesazhe të vyera mes nxënësve duke i vlerësuar ata si e ardhmja më e ndritur e vendit.

Mënyra unike e komunikimit të autorit la mbresa të shumta te nxënësit, te të cilët lindi e u zhvillua një gjendje e re shpirtërore e filozofike përgjatë takimit.



Zija Çela



Viola Isufaj



Zija Çela, Anja Azizaj

Në kuadër të aktiviteteve për muajin e letërsisë, patëm kënaqësinë të kishim në mesin tonë pedagogen, studiuesen e shkrimtaren Vjola Isufaj, si dhe kritikun e letërsisë z. Durim Çaçë.

Studiuesja Viola Isufaj mbajti një leksion shumë interesant dhe informues mbi veprën e çmuar të Ismail Kadaresë dhe rimarrjen e mitit në letërsi, ndërsa zoti Çaçë foli për kritikën, zhvillimin e saj dhe për rëndësinë e librit në jetën e njeriut si një udhërrëfyes i vyer.

Në një atmosferë të ngrohtë u shkëmbyen pyetje, përshtypje, refleksione e konstatime. Aktivitete të tilla kultivojnë te nxënësit ndjenja pozitive, vlerësim, kulturë dhe zbukurojnë vetë muajin e letërsisë në shkollën tonë.



Viola Isufaj



Durim Çaçë

TETORI ROZË

Sëmundja mund të jetë pjesë e jetës, por jo e gjithë jeta

Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit në të gjithë botën, për të rritur vëmendjen dhe mbështetjen për ndërgjegjësim, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e kësaj sëmundjeje. Por si t'i bëjmë të gjithë të kuptojnë rëndësinë e këtij muaji dhe të tematikës që trajton? Për tejçimin e këtij mesazhi, nxënësit në bashkëpunim me mësuesit realizuan një punë të mrekullueshme. Kjo punë i referohet një aktiviteti plot entuziazëm, në të cilin mbizotëronte ngjyra rozë, posterat plot domethënie dhe kordeli simbolizues.

Në hyrjen e sallës, dy nxënese mirëprisnin me buzëqeshje e ëmbëlsi, për të shpërndarë fletëpalosje të cilat përmbanin një informacion preçiz mbi kancerin e gjirit dhe mesazhe shumë inkurajuese e ndërgjegjësuere për të gjithë të ftuarit pa dallim gjinie. Më tej ndoqëm prezantimin e disa materialeve nga nxënësit e klases së 8-të, 10-të dhe të 11-të, që i bënë shikuesit më të ngrohtë si me ta edhe me tematikën. Patëm kënaqësinë të kishim në mesin tonë mjeken Anita Çela, e cila na dha infomacione tejet të vlefshme e më të detajuara për parandalimin dhe kurimin e sëmundjeve kanceroze.



Mjekja Anita Çela, mësuesja Benereta Qordja

Ajo ndau me ne një histori personale mjaft prekëse, por motivuese mbi përballjen e saj me kancerin, ku shpresa, dëshira për të jetuar dhe kujdesi ndaj shëndetit ishin baza e gjithçkaje. Ishte një kënaqësi të ishim dëgjues të një bisede aq të ngrohtë për të cilën e falenderojmë doktoreshën. Në përfundim ajo theksoi mesazhin se: “Kanceri mund të jetë pjesë e jetës por jo e gjithë jeta”. Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi për diagnostifikimin dhe kujdesin ndaj tij duhet të jetë në qendër të vëmendjes për çdo individ.

Vizitohu te mjeku që kur has dyshimet e para, shmangni justifikimet dhe mos nguro për të kërkuar ndihmë. Kështu ti shpëton një jetë dhe sheh drejt së ardhmes! Është një betejë e fitueshme me pak hapa të thjeshtë! Ti mundesh!



DITA BOTËRORE E SHËNDETTI MENDOR



Shëndeti mendor është një nga tematikat aktuale të ditëve të sotme për shkak të ndryshimeve dhe gjeneratës revolucionare së cilës i përkasim. Të rinjtë janë pikërisht ata që preken më shumë nga problemet e shëndetit mendor, duke përfshirë depresionin, ankthin dhe panikun. Ata përballen edhe me probleme të tjera, të cilat shpesh shihen si sipërfaqësore dhe të përkohshme. Këtu përfshihen bullizmi, stresi akademik, pesimizmi për të ardhmen, bipolariteti, mungesa e përqendrimit dhe e vetëbesimit. Duhet studiuar më gjerësisht për to për shkak të ndikimit të madh që kanë tek shëndeti ynë mendor.

Rëndësia më e madhe qëndron te vetëdija për këto luhatje, rreziqet që kërcënojnë mirëqenien tonë psikologjike dhe ndihma duhet kërkuar pa turp ose tabu.

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, nxënësit së bashku me psikologun e shkollës znj. Sofiona Lakuriqi dhe me mësuesen Irida Xhura,

zhvilluan një bisedë informuese dhe këshilluese me konsulenten e psiko-edukimit, studiuesen e neuroshkencës, Megi Koçiaj.

Takimi u zhvillua në formën e një bisede të ngrohtë mes psikologes së shkollës dhe të ftuarës në sallën e bibliotekës. Më pas, diskutimit iu shtua mësuesja e gjuhës lidhur me ndikimin që ka pasurimi i leksikut në lidhje me ndërtimin e marrëdhënieve njerëzore, me komunikimin si faktor kyç në jetë dhe me nxënësit, të cilët i drejtuan pyetje të ftuarës.

Ajo theksoi rëndësinë e shëndetit mendor dhe si mund të kërkojmë ndihmë lehtësisht në institucionet publike duke filluar me mjekun e familjes. Diskutuan për "Banana ditar", një platformë e krijuar nga ajo, e cila i vjen pranë çdokujt që ka nevojë për këshillim. Ajo ndau disa këshilla për menaxhimin e stresit dhe marrëdhënien me prindërit, mësuesit dhe bashkëmoshatarët, ku ruajtja e qetësisë dhe adaptimi ishin çelësi. Me pozitivitetin që e karakterizon, Megi ishte shumë pranë adoleshentëve për tematikën e diskutuar. Shëndeti mendor është një e drejtë universale e njeriut. Një mendje e qetë mirëpret mirëqenien dhe lumturinë, duke hapur gjithashtu rrugën për zhvillimin e të ardhmes.



VENDLINDJA “KOSOVA”

Kosova, pjesa e brishtë e shpirtit tonë shqiptar

Traditë në shkollën “TES” është projekti “Të njohim vendin tonë” i cili këtë vit pati në fokus Kosovën, copëzën e brishtë të shpirtit tonë shqiptar. Ne jemi një trung i përbashkët, rrënjët tona janë të ngulura thellë në atë që quhet etnitet, ndaj realizimi i këtij projekti u shoqërua me emocione të forta. I shtrirë në tre muaj projekti siguroi informim për historinë, traditën, kulturën dhe vlerat e Kosovës. Nxënësit e prekën së afërmi tokën kosovare përmes një vizite në qytetin e bukur të Prizrenit. Atje ndaluan për të vizituar monumentin historik, “Lidhja e Prizrenit”, kalanë dhe muzeun etnografik. Kënaqësi e veçantë qe vizita në shkollën “New York” në të cilën u njohëm me bashkëmoshatarët tanë dhe na bëri shumë përshtypje mikëpritja e ngrohtë, bujaria dhe dashuria që gjetëm në sofrën e tyre. Këta miq të rinj ne i ftuam për t’u bërë pjesë e aktivitetit final të projektit tonë dhe u larguam nga vizita në Prizren me zemrat plot.



Në shkollë vijuan aktivitetet dhe takimet me personalitete të ndryshme. Historiani Andi Pinari në një aktivitet të drejtuar nga mësuesja Elena Mihal informoi nxënësit mbi rrugëtimin historik të shtetit të Kosovës. Më tej Kosovën e pamë nga sytë e një poeteje. Nga sytë e poetes Fjolla Spanca, e cila rrëfeu çiltërsisht historinë e trishtë por dhe shpresëplotë të familjes së saj. Nga dhimbja, nga mundimet, nga vuajtja krijohen kryevepra. Ajo me shpirtin e saj të butë e të ndjeshëm e ka përjetësuar rrëfimin në vargjet e vëllimit poetik “Dikur kisha një titull ma t’mir”, për të cilin bisedoi me nxënësit në një takim letrar të drejtuar nga mësuesja Irida Xhura. Poetja e vuri theksin te dashuria për atdheun, për njerëzit, për jetën, tek e mira dhe e virtytshmja si e vetmja rrugë për të jetuar bukur.



Kori i shkollës dhe solistja Melodi Agolli



Alesja Halidini dhe Osman Gashi



Elena Mihal, Luljeta Basha, Andi Pinari, Flamur Gjymishka



Fjolla Spanca dhe nxënësja Ruhasana Bregu

Kur flasim për Kosovën kujtojmë rrugën e vështirë drejt pavarësisë, ndaj dhe për ta sjellë në vëmendje këtë akt historik, patëm nderin të kishim të pranishëm zotin Osman Gashi, drejtor i komunikimit ne Ministrinë e Kulturës dhe Prof. dr. Milazim Krasniqi, drejtues i Departamentit të Gazetarisë në Fakultetin Filologjik, Kosovë. Mësuesja Orilda Kalami drejtoi bisedën me të ftuarit e veçantë të cilët nuk kursyen përgëzimet dhe shprehjen e kënaqësisë për këtë projekt kaq shpirtëror.



Orilda Kalami, Osman Gashi, Milazim Krasniqi



Foto nga fjala përshëndetëse e drejtoreshës znj. Luljeta Basha



Josif Gjipali, Kastriot Tusha



Nxënësi Hansel Tota dhe Z. Milazim Krasniqi



Për të gëzuar të gjithë bashkë u organizua aktiviteti festiv, në të cilin përveç interpretimeve të nxënësve të shkollës, përveç fjalëve përshëndetëse për pavarësinë e Kosovës, një surprizë krejt e veçantë ishte performanca brilante e tenorëve Kastriot Tusha dhe Josif Gjipali. Ata elektrizuan sallën dhe dhuruan emocione të paharrueshme për të gjithë duke ofruar kështu një përmbyllje të paharrueshme të projektit.

Konferenca e Filozofisë



RAPORTI I TË RINJVE ME MEDIAN SI BURIM I SË VËRTETËS



Konferenca vjetore me temë "Raporti i të rinjve me median si burim i së (pa)vërtetës" u zhvillua në Ditën Ndërkombëtare të Filozofisë. Kjo konferencë bëri bashkë nxënës të shkollave të mesme të Tiranës, mësues, drejtues, prindër e personalitete të fushave të ndryshme.



Sonila Meço, Ervin Goci, Orilda Kalami, Blendi Salaj, Brunilda Zenelaga



Zhvillimi i mendimit kritik, analiza ndaj realitetit dhe medias sot, dilemat dhe dyshimet ndaj asaj që media ofron dhe mjaft çështje të tjera u diskutuan nga referuesit: Ervin Goci, lektor i shkencave të komunikimit, Brunilda Zenelaga, sociologe dhe pedagoge në Fakultetin e Sociologjisë në *Universitetin e Tiranës*, Sonila Meço, gazetare e moderatore, Blendi Salaj gazetar dhe Orilda Kalami, mësuese e sociologjisë dhe filzofisë. Ishte një organizim mjaft frytdhënës dhe mbresëlënës për të gjithë pjesëmarrësit. Nxënësit morën shkas nga këshillat, dilemat dhe problematikat e ngritura dhe aktuale për të përforcuar një mendim e për të fituar një qasje më të qartë krahas temës. Në konferencë u ngrit pikëpyetja që nxiti reflektim “e përdorim ne telefonin apo na përdor telefoni ne?”.



Problematikat e shumta që hasen kanë të bëjnë me përqendrimin, varësinë, humbjen e kohës dhe vërtetësisë së informacionit, individualizimin dhe shkëputjen nga jeta sociale apo dhe vetë realiteti.

U trajtua mënyra se si telefoni është bërë qendra e vëmendjes sonë dhe se si televizioni po vdes, një fatkeqësi për botën e medias, por dhe për aktualitetin tonë. Të gjithë u shprehën se media është pushteti i katërt dhe duhet trajtuar si i tillë duke mos i lejuar ndryshimet e shtrembërimet që vazhdojnë të ndodhin si pa kuptuar.



Mësuesja Orilda Kalami dhe gazetarja Sonila Meço

“KALEIDOS”

rrëmben çmimin “Sipërmarrja Sociale”




“Kaleidos” është një kompani teatrore e krijuar në kuadër të modulit “Kompania e nxënësve”. Ky modul implementohet nga organizata “Junior Achievement of Albania” dhe zhvillohet në klasën e 11-të, me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e aftësive sipërmarrëse të të rinjtë. Për të ndërthurur biznesin me artin si një mënyrë edukimi, zhvillimi e emancipimi dhe duke e cilësuar si nevojë, afrimin e të rinjve me kulturën, specifikisht me teatrin, nxënësit erdhën me këtë ide inovative.

Një prej sukseseve më të mëdha ishte edhe komedia e autorit italian Carlo Goldoni, “Zonja e Bujtinës”, me regji nga Suela Bako, që pati premierën e saj në sallën e Akademisë së Arteve, pikërisht në datë 26 Mars, një ditë para Ditës Ndërkombëtare të Teatrit. Kjo ditë e gjeti ekipin e “Kaleidos” në vendin ideal dhe më të dashur në skenë.



Nxënësit/punonjësit e “Kaleidos”-it organizojnë shfaqje teatrore ku janë vetë aktorë, në bashkëpunim me regjisorë e aktorë profesionistë, duke sensibilizuar të rinjtë për tema sociale e mesazhe domethënëse. Ata gjithashtu kanë mësuar fëmijët e parashkollorit, të cilët ishin vetë protagonistë në shfaqjen “Nata magjike” dedikuar nënave të tyre për festën e 8 Marsit. Kanë realizuar shfaqjet “Kush e ka ditëlindjen?” dhe “Librin apo telefonin” me kukullat Tili dhe Tina, personazhe shumë të dashur për fëmijët. Lanë gjurmë dhe mbresa të ëmbla jo vetëm tek fëmijët e shkollës sonë, por te të gjithë ata që e ndoqën edhe në shkollat e tyre, në Qendrën Komunitare Multidisiplinare, në emisionin “Play” apo në rrjetet sociale.

Puna e palodhur e nxënësve, mësueses Orilda Kalami dhe mentores Edlira Mali përgjatë këtyre muajve, jo vetëm që u vlerësua shumë nga të gjithë, sidomos nga anëtarët e jurisë, por edhe u shpërblye me një çmim dinjitoz në finalen e madhe. Nxënësit kthehen në shkollë me dy çmime! Çmimin “Alumni i vitit” që u fitua nga nxënësja Dea Limllari për aktivizimin dhe kontributin e saj në organizimet e “Junior Achievement” dhe çmimi më i rëndësishëm e i merituar “Sipërmarrja Sociale”. Një çmim i cili tregon shumë për vetë punën, përmbushjen e kriterëve të një sipërmarrjeje dhe përmbushjen e qëllimit për sa i përket përgjegjësisë sociale që “Kaleidos” kishte si synim të tijin. “Kaleidos” është ambicioz dhe nuk mjaftohet me kaq. Presim akoma shumë nga kompania “Kaleidos” duke i uruar suksese të mëtejshme.



REDEBATE & DEBATING ECONOMICS



Anais Osmënaj, Orilda Kalami, Arlinda Kërxfhalu, Rejsi Ahmetaj

Për të dytin vit radhazi shkolla "TES" merr pjesë në debatin e organizuar nga "Junior Achievement" me përfaqësim nga nxënëset e klasës së 12-të Rejsi Ahmetaj dhe Arlinda Kërxfhalu dhe Anais Osmënaj në klasën e 11-të. Tema e debatit për fazën e parë ishte: "This house believes that a universal basic income (UBI) is the most effective solution to address economic inequality in the age of automation".



Falë punës së një ekipi fantastik, forcës së argumentit dhe përgatitjes nga mësuese Orilda Kalami, "TES" u përball dhe mundi 4 shkolla në 4 sesione duke arritur kështu në fazën e dytë dhe të tretë të debatit. Nxënëset dëshmuar kulturën e debatit, vetëbesimin dhe punën e palodhur duke arritur çerekfinalen.

Tema e punuar kësaj here ishte : "This house believes that governments should prior kuitize investment in traditional industries over fostering the growth of the digital economy." Nxënëset dëshmuar kulturën e debatit, vetëbesimin dhe punën e palodhur duke arritur çerekfinalen. Urojmë suksese për vitet e ardhshme duke shpresuar që të arrijmë majat!



Klubi i debatit mori pjesë edhe në Kampionatin Kombëtar të Debatit "ReDebate" organizuar nga organizata "Liburnetik". Skuadra prej tetë nxënësesh Anais Osmënaj, Anja Azizaj, Dea Limllari, Sindi Sulaj, Ina Kërxfhalu, Reina Hoxha, Ana Jasmina Janku, Nadia Kalaja përfaqësuan shkollën "TES" me sukses deri në çerekfinale. Renditja në tetë skuadrat më të mira në rang kombëtar ishte fryt i përgatitjeve intensive, punës kërkimore, por edhe i bashkëpunimit, entuzizimit, përgjegjësisë, që grupi shfaqti hap pas hapi në çdo përballje. Shkolla u nderua nga ky grup fantastik.

DITA E MËSUESIT

Një mësues i mirë mund të sjellë ndryshimin në jetën e nxënësve të tij.

Dita e Mësuesit është një moment i veçantë për të shprehur mirënjohjen dhe respektin tonë ndaj mësuesve, të cilët luajnë një rol të pazëvendësueshëm në jetën e çdo nxënësi. Mësuesit janë shtylla e fortë e arsimit dhe e edukimit, falë përkushtimit me pasion dhe durim në misionin e tyre fisnik për të ndriçuar mendjet e reja.

Në këtë ditë, ne kujtojmë me vlerësim dhe respekt përpjekjet e tyre të palodhura për të na udhëhequr drejt diturisë dhe vlerave të larta morale.



“



Drejtoresha e shkollës, Luljeta Basha

”



Çdo mësues është një thesar i çmuar për shoqërinë, që formëson të ardhmen e kombit përmes edukimit të brezave të rinj. T'i falënderojmë për punën e tyre të çmuar dhe të vlerësojmë ndikimin pozitiv që kanë në jetët tona. Le të jetë kjo ditë një kujtesë e rëndësishme për të gjithë ne që të nderojmë dhe respektojmë përherë mësuesit tanë.

CAMBRIDGE NË “TES”



Panairi i përvitshëm i projekteve në Science dhe Mathematics, këtë vit me moton “The important thing is to never stop questioning”, bëri sërish bashkë nxënësit e shkollës “TES”. Nëpërmjet projekteve, eksperimenteve dhe lojërave, rrisim dëshirën dhe kuriozitetin për botën e bukur të shkencës dhe të matematikës.



Larmia e këtyre projekteve 3D, gjallëria e eksperimenteve të realizuara live dhe kreativiteti i lojërave të shpejtësisë, sollën një atmosferë festive edhe këtë vit në ambientet e shkollës sonë për Cambridge Day.

Nxënësit dëshmuuan përvetësim të njohurive, i aplikuan ato në praktikë dhe shpalosën origjinalitet. Kur loja, argëtimi e mësimi bëhen bashkë, mësimdhënia ka sukses!



Këtë vit, për herë të parë u organizua konkursi “Little Mathematician” ndërmjet nxënësve të klasave të 2-ta, të 3-ta dhe të 4-ta. Fituesit e fazës së parë nga secila klasë, u perballën në konkursin final, ku u sfiduan me pyetje logjike dhe argëtuese nga fusha e matematikës. U evidentua pasuria leksikore e anglishtes në fushën e matematikës, fryt i punës dyvjeçare me kurrikulën e Kembrixhit. Ky aktivitet u shoqërua edhe me nota muzikore nga nxënësit e talentuar, të cilët interpretuan këngë shumë të bukura për matematikën. Gjatë aktivitetit nuk munguan notat e humorit, sepse në fund zbuluam se libri i matematikës po qante, se kishte shumë probleme dhe këndi i gjerë ishte nisur për plazh se ishte mbi 90° .





Tomorrow's Education System


Tomorrow's Education System

JAVA E SHKENCËS

Përgjatë fillimit të muajit maj në "TES" u zhvillua Java e Shkencave. Nxënësit patën mundësi të aplikonin dijet e tyre shkencore duke krijuar projekte me materiale të larmishme në lëndën e teknologjisë, matematikës, fizikës, kimisë e biologjisë.

Përveçse konkretizimit të dijeve, ata gjithashtu nxitën kreativitetin si dhe punën në grup, duke punuar me bashkëmoshatarët e tyre dhe duke ndarë së bashku ide. Projektet shkencore të disiplinave të ndryshme u prezantuan nga nxënësit, të cilët demonstuan funksionin e tyre, shpjeguan materialet e përdorura si dhe iu përgjigjën kuriozitetit të pjesëmarrësve në panair.

Risi ishte prezantimi në gjuhën angleze, duke dëshmuar njohuritë e përvetësuar në SCIENCE.



KONKURSI HIPPO



Më 23-25 maj 2023, në Venecia u zhvillua faza finale evropiane e konkursit ndërkombëtar “Hippo”. “HIPPO COMPETITION” është një olimpiadë ndërkombëtare e gjuhës angleze, e organizuar çdo vit në shumë vende të botës. Në Shqipëri, kjo olimpiadë organizohet nga YES Education. Ajsel Kërçishta, nxënëse e klasës së katërt, dhe Amar Bregu, nxënës i klasës së gjashtë, arritën me sukses në fazën e dytë të konkursit “HIPPO” dhe u kualifikuan për fazën e tretë e cila u zhvillua në Venecia, Itali.



Ajsel Kërçishta



Amar Bregu

Jam shumë e emocionuar dhe e gëzuar për këtë eksperiencë të rëndësishme në Venecia, si përfaqësuese e shkollës “TES”. Unë u radhita e 13-ta nga 36 pjesëmarrës në rang evropian. Faleminderit mësues dhe të gjithë ju që më keni mbështetur! Uroj t’ju bëj krenarë gjithmonë!

Venecia ishte një vend jashtëzakonisht i bukur. Qëllimi i vizitës ishte pjesëmarrja në testin Hippo 2024, një eksperiencë krejtësisht e re për mua. Gjatë testimit ndjeva një gëzim të papërshkrueshëm. Grupi ynë përbëhej nga 63 konkurrentë me prejardhje të ndryshme dhe unë u rendita i 7-ti. Ceremonia e shpërndarjes së çmimeve ishte e bukur. Jam shumë mirënjohës ndaj mësuesve të shkollës “TES” për dijen e dhënë dhe ndaj familjes sime për mbështetjen e tyre.

JAVA E GJUHËVE TË HUAJA

Me rastin e Javës së Gjuhëve të Huaja, nxënësit e shkollës dhe stafi mësimor punuan për të krijuar një sërë aktivitete të tërheqëse dhe të veçanta.



Java filloi me një konkurs të gjuhës gjermane, ndërmjet klasave të teta. Nxënësit treguan njohuritë e tyre mbi gjuhën gjermane, duke sfiduar veten e zhvilluar aftësitë për të bashkëpunuar. Fitimtare doli klasa e 8A.

Ata diskutuan mbi pasojat e bullizmit online dhe mbajtën një mbi bullizmin online dhe atë tradicional. Debati ishte i zjarrtë, dhe ngjalli shumë ndjesi, si tek nxënësit, dhe te shikuesit.

Nxënësit e klasave të nënta, nga ana tjetër, realizuan një aktivitet për shëndetin fizik dhe mendor.

Ata shtjelluan tema mbi sëmundjet që shkaktohen tek adoleshentët, dhe synuan të rrisnin ndërgjegjësimin për të tilla problematika. Klasat e 11 bënë një shfaqje teatrale rreth miqësisë për fëmijët e klasave të 4.

Aktiviteti i nxënësve të klasave të gjashta i kushtohej mbrojtjes së mjedisit, dhe ndërgjegjësimit për ngrohjen globale, duke trajtuar kështu një temë më se të rëndësishme e aktuale. Nxënësit e klasave të treta punuan dhe krijuan një dramatizim.



Nxënësit e klasës së 8B, bënë një aktivitet kushtuar tërësisht artit e rëndësisë së tij. Ata folën e diskutuan mbi të gjitha format e artit, bashkë me një arkitekte të ftuar, Brunilda Bashën. Aktiviteti pati shumë ndikim tek gjithsecili prej nesh.

Kjo javë shërbeu si një mënyrë e nxënësve për të shprehur veten e tyre nëpërmjet aktiviteteve, për të bashkëpunuar, rritur vlerësimin ndaj gjuhës dhe për të mësuar gjëra të reja.



QEVERIA E NXËNËSVE



Mësuesja Elena Mihal me një grup nxënësishi



Mësuesja Sonila Mehmeti, nxënësja Amelia Daci

Përveç dijeve në shkenca ekzakte dhe në lëndët shoqërore, një pjesë thelbësore e misionit të shkollës “TES” është të edukojë nxënësit të jenë empatikë dhe të angazhuar për të kontribuar në përparimin e shoqërisë në çdo kohë. Ndaj, aktiviteti i radhës i organizuar nga qeveria e nxënësve të shkollës “TES” ishte mbledhja e shpërndarja e ndihmave për banorët në nevojë në fshatin Qafë Murriz.

Kjo veprimtari synon të solidarizojë, të frymëzojë dhe të promovojë vlera humane te nxënësit tanë, duke i inkurajuar ata të kontribuojnë në përmirësimin e jetës së komunitetit.

Nxënësit e shkollës “TES” kanë treguar përkushtim në përgatitjen e një surprize të veçantë në Ditën e Mësuesit, për të shprehur mirënjohjen ndaj tyre, për udhëzimin në rrugën e dijes dhe përkushtimin që tregojnë çdo moment. Ata kanë organizuar një sërë aktivitete të ndryshme dhe kanë përgatitur dhurata të veçanta, për të shfaqur dashurinë dhe respektin e tyre ndaj mësuesve. Emocionet e përjetuara i shtuan një bukuri të pamasë kësaj dite. Përkrah këtyre aktiviteteve qeveria ka qenë aktive në jetën sociale dhe ka ndërgjegjësuar të rinjtë për çështje të rëndësishme që lidhen me mjedisin dhe me altruizmin.



Asja Picari



Stafi pedagogjik i shkollës

DITA E TOKËS

22 Prilli, një thirrje për mbrojtjen e natyrës që na rrethon

Dita e Tokës, 22 prill, është një ditë e veçantë që na kujton rëndësinë e mbrojtjes së planetit tonë. Qeveria e nxënësve të shkollës sonë organizoi një sërë aktivitete për këtë ditë dhe për të ndërgjegjësuar komunitetin shkollor mbi kujdesin ndaj mjedisit. Nxënësit e shkollës mbollën lule dhe pemë, duke kontribuar në gjelbërimin e hapësirave përreth dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Ky aktivitet ndihmoi në krijimin e një mjedisi më të këndshëm dhe më të shëndetshëm për të gjithë. Përveç mbjelljes së bimëve, nxënësit gjithashtu u angazhuan në mbledhjen e plastikës për riciklim, një veprim ky që ndihmon në reduktimin e ndotjes dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Ky aktivitet jo vetëm që promovoi rëndësinë e riciklimit, por edhe tregoi se si veprimet e përditshme mund të kenë një ndikim pozitiv në mjedis. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, mësuesja Irida Xhura së bashku me klasën e 10-të yhvilluan një leksion me inxhinieren e hidrologjisë, Kristi Thodhorjani dhe më pas zhvilluan një vizitë në fabrikën e riciklimit të mbetjeve spitalore. ku u informuan mbi proceset dhe rëndësinë e riciklimit të mbetjeve të rrezikshme. Mësuesja Orilda Kalami së bashku me nxënësit mbollën një pemë për t'i dhënë gjallëri mjedisit përreth shkollës dhe përgatitën fletëpalosje e postera ndërgjegjësues.



Vizitë në fabrikën e riciklimit të mbetjeve spitalore



Mbjellja e pemës së kumbullës në oborr



Mësuese Anxhela Bushaj me nxënësit



Mësuese Flora Osmanaj me nxënësit



FESTA E A

Ju kujtohet **Festa e Abetares**, emocionet e forta, ndoshta dhe fytyrat krenare të prindërve e të mësuesve?

Të njëjtat emocione përjetuan edhe nxënësit tanë të vegjël më datë 17-të dhe 18-të Maj në "Pallatin e Kulturës" në Kamëz, ku u zhvillua Festa emocionuese e Abetares.

Sytë e prindërve shkëlqenin nga lumturia teksa shihnin fëmijët të interpretonin në skenë poezi, këngë e kërcime.

Një atmosferë vërtet e magjishme!



Mësuese Irsida Seitaj me nxënësit



Mësuese Dorina Haxhiu me nxënësit



BETARES

SUKSESE NË
RRUGËN E GJATË
E TË BUKUR TË
DIJES!





Sportet duhet të jenë pjesë shumë e rëndësishme e së përditshmes sonë. Në kuadër të aktiviteteve të shumta të organizuara nga shkolla “TES”, java e sporteve u zhvillua me një entuziazëm të veçantë. Shkolla “TES” organizoi një sërë aktiviteteve sportive, duke përfshirë futbollin dhe volejbollin.

Një fitore DRITHËRUESE



Gara u bë edhe më emocionuese me pjesëmarrjen e tre shkollave të tjera: “New York”, “Ernest Koliqi” dhe “Vatra e Dijes”, të cilat sollën një konkurrencë të fortë dhe një atmosferë dinamike. Emocionet e garës ishin të pamatshme, pasi çdo shkollë synonte të fitonte kupën dhe të tregonte aftësitë e tyre sportive. Pas shumë sfidave dhe ndeshjeve të luajtura me pasion dhe përkushtim, nxënësit e shkollës “TES” treguan një performancë të shkëlqyer. Me një angazhim të palodhur dhe një shpirt ekipi të fortë, ata arritën të siguronin fitoren në të dyja sportet, futboll dhe volejboll.



Kjo fitore ishte një burim krenarie për shkollën tonë, pasi kupa qëndroi brenda mureve të shkollës “TES”. Ky sukses është një dëshmi e punës së palodhur dhe dedikimit të nxënësve tanë, si dhe një motivim për të ardhmen. Organizimi i javës së sporteve nuk ishte vetëm një mundësi për të treguar aftësitë sportive, por edhe për të forcuar miqësitë dhe bashkëpunimin mes nxënësve dhe shkollave pjesëmarrëse.



Biblioteka e shkollës

Oazi i librave dhe i lexuesve

Biblioteka është një hapësirë kushtuar leximtarëve, një oaz i paqtë ku secili nxënës apo mësues mund të gjejë materiale dhe burime te përshtatshme që do t'i ndihmojnë ata për të realizuar hulumtimet e tyre dhe për të mbushur cilësisht kohën e lirë. Biblioteka e shkollës ka në fondin e saj rreth 850 tituj librash, shkencorë dhe artistik, që përmbushin kërkesat e çdo grupmoshe. Ajo mirëpret në mjediset e saj dhjetëra lexues çdo ditë. Këtë vit numërohen 231 regjistrime.



Në këtë hapësirë marrin jetë aktivitete të shumta letrare, zhvillohen takime me shkrimtarë dhe biseda ndërgjegjësuese me në qendër dobëtë e të lexuarit dhe përsosjen e shijes artistiko-letrare. Të tilla mund të përmendim “Libri me fletë apo digjital?” “Dita e Tokës përmes librit” “Leximtarët e vitit”, “Fantashkenca në letërsi”, “Vizitë në laboratorin e librit” etj. Nxënësit jo vetëm që mësojnë e argëtohen, por edhe motivohen me certifikata e me libra dhuratë.



Lexuesit më të mirë të bibliotekës së shkollës

Qëllimi është të edukojmë përmes të lexuarit dhe ta perceptojmë leximin e librave si një proces të kënaqshëm dhe të frytshëm.



Përmes zhvillimit të shijes artistike, të dashurisë për librin, ne kontribuojmë për një shoqëri elitare. Edukimi estetik, përshkon tërësinë e personalitetit të nxënësit dhe reflektohet në të gjitha performancat e tij shkollore e jetësore.



Klubi i pikturës

NË DREJTIMIN E MËSUESEVE
SONILA MEHMETI DHE ZAJE KASA

Jo vetëm një aktivitet plot me ngjyra dhe argëtues, por me shumë përfitime. Fëmijët mësojnë teknika të ndryshme si dhe zhvillojnë aftësi sociale, emocionale, profesionale dhe intelektuale në seancat e këtij klubi.

Detyra jonë është t'u sigurojmë atyre lirinë, materialet dhe hapësirën e nevojshme, në mënyrë që kreativiteti i tyre të lulëzojë plotësisht.



Klubi i volejbollit & i basketbollit

NË DREJTIMIN E MËSUESVE MEGI GJUZI, JETON HUQI

Sporti ka veti mahnitëse dhe të pazakonta, ai mund të njohë dhe bashkojë njerëzit, forcon shëndetin tonë dhe ndikon pozitivisht dhe në aftësitë mendore të një personi, zhvillon aftësi të dobishme të tilla si shpejtësia, reagimi i mirë, forca dhe durimi.

Falë sporteve, njerëzit bëhen më elastikë dhe rezistentë ndaj të gjithë faktorëve negativë të mjedisit të jashtëm.

Klubi i pianos & i kitarës

NË DREJTIMIN E MËSUESVE AZRA LUKACEJ, ENDRI LLAHA, ONEILA LLANAJ,
KLAUS ÇOBANI DHE YGERSO BAHJA

Aty ku fjalët mungojnë muzika flet! Të mësuarit e një instrumenti e ndihmon fëmijën të shprehet në një formë ndryshe, e zhvillon atë intelektualisht, por edhe emocionalisht! Klubi i pianos këto vite ka rezultuar shumë i suksesshëm dhe është gjithmonë në rritje!

Fëmijët e duan artin, muzikën dhe instrumentet muzikore kthehen në një mundësi për të shfaqur talentin e tyre dhe për t'u mësuar me skenën dhe emocionet që ajo të krijoj!

Kitara është një instrument shumë i bukur e i përdorur në lloje të ndryshme të muzikës. Përveç aspektit muzikor dhe artistik, mësimet e kitarës ndihmojnë në zhvillimin e aftësive thelbësore për fëmijët si rritja e përqëndrimit, vetëbesimit, durimit si dhe përmirësimit të koordinimit të aftësive psiko-motore.

Klubi i taekwondo-së

NË DREJTIMIN E TRAJNERIT JUIRDO CANI

Taekwondo, një art marcial që transmeton një filozofi të thellë të disiplinës dhe të përpjekjes së vazhdueshme për të arritur persosmërinë. Është si një udhërrëfyes i fortë dhe i besueshëm, drejt rritjes personale dhe zhvillimit të karakterit. I drejtuar nga trajneri Juirdo Cani, Klubi i Taekwondo-së pëlqehet pa masë nga nxënësit e shkollës të cilët presin me padurim çdo vit testin për të kaluar në nivelin e ri të rripit. Njëpërmjet Taekwondo-së, një sportist bëhet një krijues i vetëm i persosmërisë, duke u ngritur si shkëndija që ndriçon errësirën e vështirësive. Ky është dhe misioni ynë!



Klubi i gjuhëve të huaja

NË DREJTIMIN E SILVANA DACI, DRITA MUSABELLIU, ELDA LAÇKA

Duke përdorur metoda argëtuese, mësimi i gjuhës angleze dhe asaj gjermane është bërë edhe më i dashur për fëmijët e klubit. Përvetësimi i gjuhës së dytë përveçse përmirëson funksionimin e trurit, shton përqëndrimin dhe aftësinë për të zgjidhur probleme. Fëmijët mësojnë për kultura të ndryshme dhe udhëtojnë virtualisht në të gjithë botën.





AT THE

pool *Klubi i notit*

ME SHOQËRIMIN E MËSUESES XHULJANA ADILI

Ky sport kaq i bukur dhe sfidues zhvillohet nga profesionistë të fushës duke iu kalitur fëmijëve disiplinën, rezistencën dhe ambicien.



Klubi i robotikës

NË DREJTIMIN E INSTRUKTORIT ILIR CENGU


Duke ndërvepruar me njëri-tjetrin nxënësit kanë ndërtuar robotë nga më të ndryshmit. Përmes programimit ata i kanë dhënë “jetë” robotëve, të cilët lëvizin në forma dhe mënyra të ndryshme. Sa qejf kur njohuritë e reja dhe format përmes së cilës i marrim janë të bukura e argëtuese!





Klubi i programimit

NË DREJTIMIN E MËSUESIT ARMAND DUHANI

Klubi i programimit vazhdon ecurinë e tij me nxënësit e shkollës “TES”. Ky klub ka ngjallur shumë interes te nxënësit e të gjitha moshave. Aktualisht në klub zhvillohen gjuhë programimi sipas niveleve dhe grupmoshave në platforma të ndryshme. Ndër platformat dhe gjuhët e përdorura janë: Scratch, CodeMonkey, HTML, CSS, Javascript etj.





Ekspozita “Brezi i humbur”

Ndërthurja mes artit, historisë dhe letërsisë solli ekspozitën "Brezi i humbur", ideuar nga mësueset Sonila Mehmeti dhe Elena Mihal.

Ekspozita e fundvitit nga klasat e teta pati larmishmëri punimesh të stileve të artit të Brezit të humbur si surrealizmi, postimpresionizmi, kubizmi, abstraksionizmi dhe futurizmi. Këto rryma artistike u ndërthurën me muzikën e Anton Veber, Arnold Sholenberg, Igor Straviski dhe veprat letrare të disa prej shkrimtarëve të këtij brezi si Ernest Heminguej, Erih Maria Remark dhe shkrimtari shqiptar Petro Marko. Këta të fundit shkruajtën për tmerret e luftës mes dhimbjes, dashurisë dhe realitetit të kohës. Ata panë të shembeshin në fushëbeteja idealet e ëndrrat rinore.



Ekspozita u soll në ambientet e shkollës plot ngjyra dhe me riprodhimin e pikturave më të famshme të artistëve.

Qasja drejt artit, letërsisë dhe historisë pati qëllim njohjen e veprave botërore.

“Nuk është e tmerrshme të presësh diçka, e tmerrshme është të mos kesh çfarë të presësh...”



Ekspozita vjetore e klubit të pikturës

Gjithmonë jemi të prirur të themi se funksioni i artit në jetën tonë është vetëm vizual, diçka e kënaqshme nga ana estetike dhe që shërben si dekor, por harrojmë të përmendim qëllimin e vërtetë të artit, atë të ushqimit të botës shpirtërore, të brendisë sonë, të qenies sonë.

Pikërisht me këtë synim u organizua ekspozita vjetore e Klubit të Pikturës. E kush më mirë se talentet e reja mund të na mësojnë të vlerësojmë, të shijojmë dhe të kultivojmë pasionin tonë për botën e magjishme të ideve dhe ndjenjave?

Përmes çdo punimi ne shohim një dritare të hapur në botën e tyre të brendshme, duke na dëshmuar perspektiva të ndryshme të të parit të botës nga sytë e fëmijëve. Nën drejtimin e mësueses Sonila Mehmeti, nxënësit kanë punuar në përvetësimin e teknikave të ndryshme si pasteli, akriliku, tezgjahu, karboni, argjili etj.

Gjithashtu kanë thelluar konceptet e tyre në rrymat e post-Impresionizimit dhe pop-artit. Gjërat e mëdha bëhen nga një seri e gjërave të vogla që bashkohen.





Triumfues në konkurse

2024



Belkis Agolli

Gold Medal
Art and Design
OWLYPIA



Ketnis Xhaxhe

Silver Medal
Art and Design

OWLYPIA



Asia Strazimiri

Gold Medal
Literature and Culture
OWLYPIA



Ema Molla

Bronze Medal
Art and Design

OWLYPIA



Majda Dollaku

Gold Medal
"Math without border"

TEEN EAGLE 2024



REJAN DARSI



ENES XHABRAHIMI



NED INDRIZLLARI



TeenEagle

OLIMPIADA E LETËRSISË



REJSI AHMETAJ

KLASA XII

Fituese e fazës së dytë në
Olimpiadën Kombëtare të Gjuhës
shqipe dhe të Letërsisë

ANAIS OSMËNAJ

KLASA XI

Fituese e fazës së dytë në
Olimpiadën Kombëtare të Gjuhës
shqipe dhe të Letërsisë



ANJA AZIZAJ

KLASA X

Fituese e fazës së dytë në
Olimpiadën Kombëtare të Gjuhës
shqipe dhe të Letërsisë



Kryeredaktore:

Irida Xhura

Redaktore:

Asja Picari

Rejhana Husha

Emili Hoxha

Gazetarë/tekstshkrues:

Dea Limllari

Redion Cara

Samanta Haxhi

Emili Hoxha

Grafika:

Jurgesa Bulku

Dizajni:

Anais Osmënaj

Redion Cara

Asistent dizajni:

Amri Sulejmani

Anri Goci

Bekim Allaraj

Eden Masha



shkolla_tes



Shkolla Tomorrow's Education System



<https://tes.al/>



+355 69 370 0037